



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/114
Datë: 26.11.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 paragrafi 1. dhe 2. të Ligjit Nr. 04/L-177 për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës Jashtë Vendit (GZ/Nr. 18/28 maj 2013) dhe të nenit 4 paragrafi 3. të Rregullores (QRK) - Nr. 34/2013 për Financimin e Dërgimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës Jashtë Vendit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 nëntor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Mbrojtjes për dërgimin e kontingjentit të FSK-së në operacion humanitar në Republikën e Shqipërisë.
2. Mjetet financiare për dërgimin e kontingjentit të FSK-së në operacion humanitar sipas pikës 1. të këtij vendimi sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë Presidentit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe autorizim të dërgimit të kontingjentit të FSK-së në operacion humanitar.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/114
Datë: 26.11.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, paragrafit 2 neni 15 i Ligjit Nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 nëntor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 500,000 euro. Mjetet financiare merren nga Ministria e Financave me kod 201, nënprogrami Kontigjencat në Ministrinë e Financave me kod 28900 nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime dhe transferohen në Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nënprogrami Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të rezervës.
2. Mjetet në shumë prej 500,000 euro nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nënprogrami Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100 kategoria e Shpenzimeve të Rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave në nën programin Thesari me kod 11200 në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere.
3. Shuma prej 500,000 euro nga pika 2. e këtij vendimi ndahen për ndihmë Republikës së Shqipërisë me rastin e tërmetit të ndodhur me datë 26.11.2019.
4. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë